



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.412/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Blerta Deliu kandidate për deputete nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet** si e bazuar ankesa e Kandidates për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Blerta Deliu nga koalicioni PDK-AAK-NISMA,
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA në Vendvotimin 2102B/01R
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutive të votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 30.06.2017 në ora 13:25, nga Blerta Deliu - Kodra kandidate për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit PAN me seli në Prishtinë, në të cilën pretendon se pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të publikuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) ka vërejtur parregullsi në vendvotimin 2102B/01R me të cilën nuk figuron asnjë votë e saj. Parashtruesja e ankesës pretendon se është e bindur që në këtë vendvotim kanë pasur vota të konsiderueshme dhe shpreson që lëshimi të sqarohet, si dhe vendvotimi në Qubrel të rishikohet.

Ne mbështetje të pretendimeve në ankesë, ankesës i është bashkangjitur Formulari i Rezultateve të Kandidatëve (FRK).

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezultojnë edhe nga provat e ofruara si dëshmi nga vete pala ankuese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga koalicioni PDK-AAK-NISMA në këtë vendvotim: 2102B/01R në shkollën Vilezrit Frashri, fshati Qubrel dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 412/2017 më datën 02.07.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha**



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.